



**VENDIM**

Nr. 35 Date 13.10.2014

**PER MIRATIMIN E STRUKTURES SE ADMINISTRATES TE "PARKUT  
NATYROR RAJONAL – LIQENI I FIERZES"**

• Keshilli i Qarkut Kukës në mbledhjen e tij të datës së mesipërme, pas shqyrtimit të Relacionit të paraqitur nga AZHR-ja, bazuar në ligjin Nr.8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,, nenet 7/2, 8/1/1/b/c/ç,13, 54/d/1, ligjin Nr.8485 datë 12.05.1999 "Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", ligjin Nr. 9868, datë 04.02.2008 "Për zonat e mbrojtura", (i ndryshuar) neni 11/1, VKM Nr.519, datë 30.06.2010 "Për proçedurat e propozimit e të miratimit dhe rregullat e administrimit të parqeve natyrore rajonale" pikat 3 dhe 4/e, si dhe vendimin e Kryesise së Keshillit të Qarkut Kukës, Nr.20, datë 13.10.2014 "Për miratimin e P/Akteve për mbledhjen e Keshillit të Qarkut Kukës".

**VENDOSI:**

1. Miratimin e strukture së administrates të "Parkut Natyror Rajonal - Liqeni i Fierzes", sipas Aneksit Nr.1, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Kjo strukture do të shërbejë për mbrojtjen e natyres, biodiversitetit, të llojeve floristike e faunistike dhe të ekosistemeve natyrore të këtij parku si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të zones.
3. Administrata e "Parkut Natyror Rajonal - Liqeni i Fierzes" administron dhe menaxhon në bashkëpunim me strukturat perkatese të njesive vendore si dhe institucione të tjera, sipërfaqet e përdorimit të territorit të përcaktuara në vendimin e Keshillit të Qarkut Kukës, sipas hartës që i bashkëngjitet këtij vendimi.
4. Detyrat e administrates të "Parkut Natyror Rajonal - Liqeni i Fierzes" përcaktohen në dispozitat e ligjore dhe nenligjore "Për zonat e mbrojtura" si dhe në rregulloren e administrimit dhe funksionimit të miratuar nga Keshilli i Qarkut Kukës.
5. Zyrat e strukture së administrates të "Parkut Natyror Rajonal - Liqeni i Fierzes" do të jenë brenda ambienteve të Keshillit të Qarkut Kukës.
6. Përkrahjet e punës, detyrat dhe funksionet e punonjësve të "Parkut Natyror Rajonal - Liqeni i Fierzes" do të përcaktohen në Planin e Menaxhimit të Parkut.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI I QARKUT KUKES**





7. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen, Kryetari, Sekretari i Keshillit te Qarkut Kukës, Agjensia e Zhvillimit Rajonal si dhe Drejtoria e Menaxhimit te Burimeve Njerezore.


8. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere


**KRYETARI**

**Ibsen ELEZI**



Konc: I.Shahu 

Ligshmeria: G.Çejku 

Sekretari: B.Ngjeçi 

U hartua ne 3 (tre) kopje origjinale:

1. Zyres se Arkivit
2. Institucionit te Prefektit te Qarkut Kukës
3. Agjencise se Zhvillimit Rajonal

REPubLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI I QARKUT KUKES




Aneksi Nr.1

STRUKTURA DHE NUMRI I PUNONJESVE TE ADMINISTRATES TE  
"PARKUT NATYROR RAJONAL - LIQENI I FIERZES"

Nr.	Funksioni	Profili	Nr. Pers.
1	Menaxheri i Parkut	I Larte	1
2	Specialist per komunikimin dhe marredheniet me publikun	I Larte	1
3	Specialist per biodiversitetin	I Larte	2
4	Specialist Finance	I Larte	1
Nr. Total i Punonjesve			5

KRYETARI

Ibsen ELEZI



Konc: I.Shahu

Ligjshmeria: G.Çejku

Sekretari: B.Ngjeçi

U hartua ne 3 (tre) kopje origjinale:

1. Zyres se Arkivit

2. Institucionit te Prefektit te Qarkut Kukës